



181/3

2108

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 4681/ProtFushë-Arrëz, më 19.01.2023

Lënda: Kthim përgjigjie

QENDRA "RES PUBLICA"
BLV "GJERGJ FISHTA", ND.24, H.3, AP.7, TIRANË

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" ; VKM-në nr.60 datë 26.1.2022 të këshillit të ministrave "Për Shpalljen e ekosistemeve natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar / Park Natyror (Kategoria IV) si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore që i përkasin kësaj kategorie", si dhe referuar Shkresës nr.181/22 Prot datë 02.12.2022 "Kërkesë për informacion dhe në venie në dispozicion e dokumentacionit", ju informojme si më poshtë:

Bashkia Fushë-Arrëz ka dhënë Letër mbështetje me nr.3072 datë 18.09.2018 drejtuar MTM dhe AKZM. Bashkia Fushë-Arrëz ka marr pjesë në dëgjuesat publike të organizara për shpalljen e Malit të Munelles zonë e mbrojtur.

Në vlerësojmë këtë zonë si aset natyrore me biodiversitet të lartë dhe shtëpia e një prej specieve në rrezik zhdukje si Riqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx ssp. Balcanicus*). Gjithashtu ju sqarojmë se arsya e voneses në kthimin e përgjigjies është gjetja në arkive e dokumentit të leshuar gati para 5 viteve.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Letër mbështetëse nr.3072 datë 18.09.2018.

Faleminderit për mirëkuptimin.

KRYETARI

Fran Tuci





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 3072, Prot.

Fushë-Arrëz, më 18.09.2018

Lënda: Letër mbështetëse

Drejtuar: Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Tiranë



Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura

Tiranë

Bashkia Fushë-Arrëz ka nën kujdesje të veçantë resurset dhe pasuritë natyrore të ndodhura në territorin e saj. Një ndër vlerat më të mëdha natyrore që ndodhet në territorin e bashkisë është rajoni i malit të Munellës. Nisur nga studimet e kryera nga Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA), zona e malit të Munellës është vërtetuar si bërthama e riprodhimit për rrëqebullin e Ballkanit *Lynx lynx ssp. balcanicus*, specie e rrezikuar në mënyrë kritike, në Shqipëri. Kjo zonë është gjithashtu e rëndësishme për karnivorë të tjerë të mëdhenj, por edhe për grupe të tjera të faunës së egër me interes për tumbrojtur si shpendë, amfibë, zvarranikë dhe lakuriqë nate. Nisur nga këto vlera të jashtëzakonshme Bashkia Fushë-Arrëz shpreh mbështetjen e saj ndaj propozimit për shpalljen e zonës së malit të Munellës si zonë të mbrojtur.

Shpallja e zonës së malit të Munellës si zonë e mbrojtur shihet si mundësi e mirë për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit, zinxhirit ushqimor të tij, si dhe pyjet në të cilat strehohet kjo specie e rrezikuar. Gjithashtu me shpalljen e kësaj zonë si zonë të mbrojtur do të promovohet e gjithë zona si zonë me biodiversitet të lartë duke rritur mundësinë e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm që mund të çojë në rritjen e treguesve ekonomik-social të zonës dhe krijimin e mundësive të punësimit për banorët.

Me qëllim ruajtjen dhe rimëkëmbjen e popullatës së Rrëqebullit të Ballkanit, si dhe mbrojtjen e vlerave të tjera natyrore, kulturore dhe historike të zones së Munellës, si një trashëgimi për brezat e ardhshëm, Bashkia Fushë-Arrëz mbështet propozimin për shpalljen e Zonës së Munellës si Zonë e Mbrojtur. Ky proces është shoqëruar me konsultime të vazhdueshme me banorët e zonës, të cilët në shumicë janë shprehur në favor të shpalljes së Munellës zonë e mbrojtur. Institucioni që ne përfaqësojmë shpreh mbështetjen dhe gatishmërinë e plotë në ndërmarrjen dhe plotësimin e të gjitha hapa vetë nevojshme për finalizimin e këtij procesi.

KRYETARI

Fran Tuci

